



## **Partia e Drejtësisë- PD**

**Raportet financiare të fushatës dhe Raporti i Auditorëve të Pavarur**

Zgjedhjet Lokale  
Për periudhën 16 Shtator deri 15 Tetor 2021

**Përmbajtja:**

Raport i auditorëve të Pavarur.. .....	3-5
Pasqyra e Pozitës Financiare.....	6
Pasqyra e të Hyrave dhe Shpenzimeve.....	7
Informata të përgjithshme .....	8
Shënimet e pasqyrave financiare.....	9-13

# **Raport i Auditorëve të Pavarur**

**Drejtuar Kryesisë të SP Partia e Drejtësisë-PD**

**Raport mbi Pasqyrat Financiare për qëllime specifike**

## **Mohim i Opinionit**

Ne kemi qenë të angazhuar për të audituar pasqyrat financiare mbi Raportet e Deklarimit Financiar të Fushatës të Subjektit Politik “Partia e Drejtësisë (në vijim referuar si “Subjekti Politik” apo “PD”), të përbëra nga Pasqyra e Pozitës Financiare me 15 Tetor 2021, Pasqyra e të Hyrave dhe Shpenzimeve për periudhën nga 16 Shtator 2021 deri 15 Tetor 2021, dhe informacionin tjetër shpjegues të përfshira në faqet prej 9-13.

Ne nuk shprehim një opinion mbi Raportet e Deklarimit Financiar të Fushatës të subjektit politike Partia e Drejtësisë në datën 15 Tetor 2021. Për shkak të rëndësisë së çështjeve të përshkruara në paragrafin bazat për mohim të opinionit, ne nuk kemi qenë në gjendje të sigurojmë nga SP evidencën e nevojshme dhe të mjaftueshme të auditimit për të patur një bazë për një opinion të auditimit për Raportet e Deklarimit Financiar të fushatës për SP.

## **Bazat për Mohim të Opinionit**

- Subjekti Politik nuk ka plotësuar drejt pasurinë, ekuitetin dhe detyrimet me 15 Tetor 2021 dhe 16 Shtator 2021, po ashtu shënimet e prezantuara në Pasqyrat Financiare nuk mbështeten me dëshmi relevante lidhur me zërat e pasqyrave financiare të SP me 31 Dhjetor 2021 ashtu siç kërkohet me ligjin Nr. 04/L-212 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 për financimin e subjekteve politike, të ndryshuara dhe plotësuara me ligjin Nr. 04/L-058, Neni 15 Raportimi Financiar. Duke pasur parasysh natyrën e shënimeve që mban subjekti politik, ne e kishim të pamundur të përcaktojmë korrigjimet e nevojshme me 15 Tetor 2021 dhe 16 Shtator 2021.
- Subjekti politik nuk ka prezantuar drejt te hyrat dhe shpenzimet për periudhën 16 Shtator 2021 deri me 15 Tetor 2021 dhe pas parasysh natyrën e shënimeve që mban subjekti politik dhe dokumentacionin e ofruar ne nuk ishim në gjendje të japim një opinion në lidhje me te hyrat dhe shpenzimet e njohura në pasqyrën e te ardhurave apo pajtueshmërinë e tyre me ligjin Nr. 04/L-212 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 për financimin e subjekteve politike, të ndryshuara dhe plotësuara me ligjin Nr. 04/L-058.

## **Theksim i çështjes**

Ne poashtu tërheqim vëmendjen në lidhje me gjetjet e mëposhtme:

- Subjekti Politik nuk ka mirëmbajtur kontabilitet të mirëfilltë për të mundësuar regjistrimin e të gjitha transaksioneve financiare të ndodhura dhe përgatitjen e pasqyrave financiare sipas kërkesave të standardeve të kontabilitetit të aplikueshme në Kosovë.

- Subjekti Politik nuk e ka të definuar me Statut, mundësinë e ushtrimit të kontrollit të brendshëm financiar të saj dhe të drejtën e anëtarëve për t'u informuar për të gjitha të hyrat dhe shpenzimet e subjekteve politike si dhe për përgjegjësinë e organit gjegjës për transaksionet financiare, ashtu siç parashihet në ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 17 Kontrolli i Brendshëm.
- Subjekti Politik nuk ka llogari bankare aktive .

### **Përgjegjësia e menaxhmentit dhe e atyre te ngarkuar me qeverisje për Pasqyrat Financiare**

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058 dhe për ato kontrole të brendshme që menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së subjektit politik për të vazhduar aktivitetin e saj (parimi i vijimësisë), shpalosjen, sipas rastit, të çështjeve që lidhen me parimin e vijimësisë dhe përdorimin bazës së kontabilitet sipas parimit të vijimësisë përveç nëse menaxhmenti synon të likuidojë Subjektin Politik ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë realiste përveç për ta bërë këtë.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të kompanisë.

### **Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e Pasqyrave Financiare**

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi, dhe për të nxjerrë raportin e një auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomali të mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticismin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me

qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.

- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Audit & Conto sh.p.k

---

Muhamet Feka  
Auditor Ligjor  
18 Tetor 2023

**Partia e Drejtësisë-PD***Pasqyrat Financiare për periudhën 16 Shtator 2021 deri me 15 Tetor 2021***Pasqyra e Pozitës Financiare**

<b>Pasuritë</b>		<b>Bilanci në fundë të periudhës</b>	<b>Bilanci në fillim të periudhës</b>
<b>Pasuritë afatgjata</b>	Shënimi	<b>Shuma në Euro</b>	<b>Shuma në Euro</b>
Toka, objektet dhe pajisjet	5	0.00	0.00
Pasuritë e paprekshme		0.00	0.00
Pasuritë tjera afatgjata		0.00	0.00
<b>Total pasuritë afatgjata</b>		<b>0.00</b>	<b>0.00</b>
<b>Pasuritë afatshkurtra</b>			
Llogaritë e arkëtueshme	6	0.00	0.00
Parapagimet			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	7	0.00	0.00
Pasuritë tjera afatshkurtra			
<b>Total pasuritë afatshkurtra</b>		<b>0.00</b>	<b>0.00</b>
<b>Total pasuritë</b>		<b>0.00</b>	<b>0.00</b>
<b>Ekuiteti</b>			
Fondet e akumuluar		0.00	0.00
Suficiti / (deficiti) i vitit		0.00	0.00
<b>Total Ekuiteti</b>		<b>0.00</b>	<b>0.00</b>
<b>Detyrimet</b>			
<b>Detyrimet afatgjata</b>			
Huatë e pagueshme		0.00	0.00
Të hyrat e shtyera		0.00	0.00
<b>Gjithsej detyrimet afatgjata</b>		<b>0.00</b>	<b>0.00</b>
<b>Detyrimet afatshkurtra</b>			
Llogaritë e pagueshme dhe të tjera	8	1,400.00	0.00
Huatë e pagueshme			
Detyrimet tjera afatshkurtra	9	0.00	0.00
<b>Gjithsej detyrimet afatshkurtra</b>		<b>1,400.00</b>	<b>0.00</b>
<b>Gjithsej detyrimet</b>		<b>1,400.00</b>	<b>0.00</b>
<b>Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet</b>		<b>1,400.00</b>	<b>0.00</b>

**Partia e Drejtësisë-PD***Pasqyrat Financiare për periudhën 16 Shtator 2021 deri me 15 Tetor 2021***Pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve**

	Shënimi	16 shtator 2021 deri 15 tetor 2021
<b>Të hyrat</b>		
Të hyrat nga buxheti		0.00
Të hyrat nga anëtarësia		0.00
Donacionet dhe kontributet në të holla	3	1,400.00
Kontributet në natyrë në mall dhe shërbime	4	0.00
Të hyrat tjera		0.00
<b>Gjithsej të hyrat për vitin</b>		<b>1,400.00</b>
<b>Shpenzimet</b>		
Pagat dhe kompensimet	2	0.00
Shpenzimet e transportit	2	0.00
Reklamat, reprezentacioni dhe konferencat	2	0.00
Blerja e mallrave	2	0.00
Shpenzimet e përgjithshme	2	0.00
Shpenzimet e ndryshme	2	1,400.00
<b>Gjithsej shpenzimet për vitin</b>	<b>2</b>	<b>1,400.00</b>
<b>Suficiti / (deficiti) për vitin</b>		<b>0.00</b>

## **Partia e Drejtësisë-PD**

*Shënimet për Pasqyrat Financiare zgjedhjet lokale 16 Shtator 2021 deri 15 Tetor 2021*

---

### **1. Informata të Përgjithshme**

PARTIA E DREJTËSISË-PD

Udhëheqja: Ferid Agani (Kryetar i partisë)  
Përfaqësues i autorizuar financiar – Eroll Venhari  
Prezentuesi gjat Auditimit Eroll Venhari  
Selia e partisë: Rr. Mustafë Kruja P.n. , Prishtinë

Pasqyrat financiare të Partia e Drejtësisë (më tutje “PD”) nuk janë përgatitur sipas kërkesave të Ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 15 Raportimi Financiar.

Bazuar në nenin 19 paragrafi 2 pika 7 e Ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058 „Subjekti i regjistruar politik brenda pesë (5) ditëve të punës nga marrja e draft raporteve të audituara mund ta dorëzoj raportin e rishikuar financiar dhe shpjegimet lidhur me gabimet ose lëshimet të identifikuara nga auditorët.

Subjekti Politik ka dy llogari bankare te bllokuara në bankat në Kosovë dhe nuk ka nje lloagri aktive.



**Partia e Drejtësisë-PD***Shënimet për Pasqyrat Financiare zgjedhjet lokale 16 Shtator 2021 deri 15 Tetor 2021***Shënimi 2. Shpenzimet**

<b>Shpenzimet</b>	Shpenzimi në Euro	Pagesa në Euro	Borxhi i mbetur në Euro
<b>Pagat dhe kompensimet</b>			
Pagat dhe kompensimet, neto	0.00	0.00	0.00
Kontributet pensionale të punëmarrësit	0.00	0.00	0.00
Kontributet pensionale të punëdhënësit			
Tatimet në të ardhura personale			
Beneficionet tjera	0.00	0.00	0.00
<b>Gjithsej</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>
<b>Shpenzimet e transportit</b>			
Automjetet motorike të huazuara			0.00
Karburantet	0.00	0.00	0.00
Biletat, aeroplanit/autobusit/trenit/taksit etj.	0.00	0.00	0.00
Sigurimi dhe mirëmbajtja e veturave			0.00
Çdo shpenzim tjetër i transportit	0.00	0.00	0.00
<b>Gjithsej shpenzimet e transportit</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>
<b>Reklamat, reprezentacioni dhe konferencat</b>			
Lokali	0.00	0.00	0.00
Ushqimi	0.00	0.00	0.00
Aktivitete kulturore dhe rekreative			0.00
Radio dhe spotet televizive			0.00
Stendat e afishmit dhe reklamimet në gazeta	0.00	0.00	0.00
Shpenzimet tjera të reklamave, reprezentacionit dhe konferencave	0.00	0.00	0.00
<b>Gjithsej reklamat, reprezentacioni dhe konferencat</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>
<b>Blerja e mallrave</b>			
Furnizimi i zyrës	0.00	0.00	0.00
Pajisjet të vogla	0.00	0.00	0.00
<b>Gjithsej blerja e mallrave</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>
<b>Shpenzimet e përgjithshme</b>			
Qiraja e lokalit të zyrës	0.00	0.00	0.00
Telefoni, interneti dhe posta	0.00	0.00	0.00

## Partia e Drejtësisë-PD

Shënimet për Pasqyrat Financiare zgjedhjet lokale 16 Shtator 2021 deri 15 Tetor 2021

Rryma, shërbimet komunale (uji dhe mbeturinat)	0.00	0.00	0.00
Gjoha dhe ndëshkime	1,000.00	//////////	//////////
Shpenzimet lidhur me donacionet dhe kontributet në natyrë në mallra dhe shërbime		//////////	//////////
<b>Gjithsej shpenzimet e përgjithshme</b>	<b>1,000.00</b>	<b>0.00</b>	<b>1,000.00</b>
<b>Shpenzimet e ndryshme</b>			
Mirëmbajtja e pajisjeve dhe hapësirave të zyrës	0.00	0.00	0.00
Shpenzimet që nuk janë përfshirë në asnjë kategori tjetër	400.00	0.00	400.00
<b>Gjithsej shpenzimet e ndryshme</b>	<b>400.00</b>	<b>0.00</b>	<b>400.00</b>
<b>Gjithsej shpenzimet</b>	<b>1,400.00</b>	<b>0.00</b>	<b>1,400.00</b>

### Shënimi 3: Donacionet dhe kontributet në të holla

Pranuar nga			Data kur është dhënë kontributi	Vlera në euro	E pranuar përmes:	
Kontribuesi	Adresa	Numri personal			Bankë	Arkë
Eroll Venhari	Haxhi Zeka		23.08.2021	100.00		✓ 100.00
Ferid Agani	Prishtine		23.08.2021	200.00		200.00
Bahri Bokshi	Gjakove		23.08.2021	200.00		200.00
Gezim Shala	Gjilan		23.08.2021	200.00		200.00
Vesel Neziri	Mitrovice		23.08.2021	100.00		100.00
Ali Ismaili	Fushe Kosove		23.08.2021	100.00		100.00
Shpetim Potera	Prishtine		23.08.2021	50.00		50.00
Agim Qehaja	Prishtine		23.08.2021	50.00		50.00
Qemal Hasani	Prishtine		23.08.2021	50.00		50.00
Esat Ejupi	Prishtine		23.08.2021	100.00		100.00
Xhylje Ibrahim	Gjilan		23.08.2021	100.00		100.00
Albulena Sylejmani	Gjilan		23.08.2021	100.00		100.00
Skender Berisha			23.08.2021	50.00		50.00
<b>Gjithsej donacionet dhe kontributet në të holla</b>				<b>1,400.00</b>	<b>0.00</b>	<b>1,400.00</b>

**Shënimi 4: Kontributet në natyrë në mall dhe shërbime**

Përshkrimi i mallit / shërbimit	Pranuar nga			Data kur është dhënë kontributi	Vlera
	Kontribuesi	Adresa	Numri personal		në euro
<b>Gjithsej kontributet në natyrë në mall dhe shërbime</b>					<b>0.00</b>

**Shënimi 5: Toka, objektet dhe pajisjet**

	Bilanci në fillim të vitit (kosto historike)	Blerjet gjatë vitit	Zhvlerësimi i akumuluar	Zhvlerësimi i vitit	Bilanci në fundë të vitit (vlera neto)
Toka					<b>0.00</b>
Objektet					
Veturat					
Pajisjet e zyrës					
Pajisjet e teknologjisë informative					
Pajisjet tjera					
<b>Gjithsej toka, objektet dhe pajisjet</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>			<b>0.00</b>

**Partia e Drejtësisë-PD***Shënimet për Pasqyrat Financiare zgjedhjet lokale 16 Shtator 2021 deri 15 Tetor 2021***Shenime tjera**

<b>Shënimi 6. Llogari të arkëtueshme</b>	<b>Bilanci në fundë të periudhës Shuma në Euro</b>	<b>Bilanci në fillim të periudhës Shuma në Euro</b>
.....bleresi 1		
.....bleresi 2		
<b>Gjithsej Llogarit e arkëtueshme</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>

<b>Shënimi 7. Paraja dhe ekuivalentët e parasë</b>	<b>Bilanci në fundë të periudhës Shuma në Euro</b>	<b>Bilanci në fillim të periudhës Shuma në Euro</b>
Paraja në bankë	0.00	0.00
Paraja në arkë	0.00	0.00
<b>Gjithsej paraja dhe ekuivalentët e parasë</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>

<b>Shënimi 8. Llogaritë e pagueshme dhe të tjera</b>	<b>Bilanci në fundë të periudhës Shuma në Euro</b>	<b>Bilanci në fillim të periudhës Shuma në Euro</b>
.....furnitori 1		
.....furnitori 2		
.....furnitori 3		
.....furnitori 4		
Llogari të pagueshme të tjera	0.00	0.00
<b>Gjithsej llogaritë e pagueshme dhe të tjera</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>

<b>Shënimi 9. Detyrimet tjera afatshkurtra</b>	<b>Bilanci në fundë të periudhës Shuma në Euro</b>	<b>Bilanci në fillim të periudhës Shuma në Euro</b>
Detyrimet për paga dhe tatime	0.00	0.00
Detyrimet për qira	0.00	0.00
Detyrimet për gjoba dhe ndëshkime	1,400.00	0.00
Detyrime tjera afatshkurtër (huazimet)	0.00	0.00
<b>Gjithsej detyrimet tjera afatshkurtra</b>	<b>1,400.00</b>	<b>0.00</b>

